



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 299

Ora: 12:00

VENDIM

MBI PROCESIN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT PËR KRYETARËT E DISA BASHKIVE, PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie, për subjektin zgjedhor "Partia Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Subjektet zgjedhore, në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike.

Subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", me shkronja nistore "PDSH", ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionet përkatëse për të gjithë kandidatët, bazuar në udhëzimin nr. 1. datë 18.01. 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Data: 5.4.2023 Nr: 299
Ora: 12:00



"Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e disa bashkive, për subjektin zgjedhor "Partia Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të kandidatëve për kryetarë bashkie rezulton se asnjë e dhënë nuk është në kundërshtim me ndalimet e parashikuara nga ligji. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat për kryetar bashkie. Nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie rezulton se, nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 dhe janë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pikat 2, shkronja "b" e 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nëpërmjet postës elektronike, për kandidatët për kryetar bashkie që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për kryetar bashkie sipas së cilës rezulton se kandidatët nuk janë në kushtet e ndalimit dhe nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, edhe pse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është nisur lista për verifikim, ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nga kandidatët për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor "Partia Demokratike", nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Referuar nenit 33, shkronja "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Për sa më sipër, KZAZ-të duhet të vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PËR KËTO ARSYE:

Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit, për kandidatët për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, për bashkitë sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Partia Demokratike

NR	BASHKIA	KANDIDATI
1	Bashkia Dimal	Dritan Sula
2	Bashkia Kuçovë	Ilirjan Koxhaj
3	Bashkia Mallakastër	Agron Kapllanaj
4	Bashkia Patos	Pranvera Rizaj
5	Bashkia Gjirokastrë	Shemsho Lamaj
6	Bashkia Këlcyrë	Adriatik Spahiu
7	Bashkia Tepelenë	Sokol Guga
8	Bashkia Vau-Dejës	Klomentina Drini
9	Bashkia Finiq	Leonidha Papa
10	Bashkia Sarandë	Skënder Muco
11	Bashkia Mirditë	Mark Ruci
12	Bashkia Dibër	Naim Gazidede